



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT  
MUNICIPALITY OF DEÇAN  
OPSTINA DEÇAN



Drejtoria për Inspektion  
Nr. 10 \_\_\_\_/2026

|                       |                                                        |
|-----------------------|--------------------------------------------------------|
| Datë/Data             | 02.07.2026                                             |
| Për/To/Za             | Bashkim RAMOSAJ- kryetar i Komunës                     |
| Nga/from/Od           | Ibrahim Selmonaj- Drejtor i Drejtorisë për Inspekcione |
| Tema/Subject/Subjekat | RAPORT I PUNËS PËR PERIUDHEN JANAR-QERSHOR 2026        |


Drejtoria për Inspekcione gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit kalendarik 2026 kanë zbatuar përgjegjësitë e tyre zyrtare konform Ligjeve, akteve nënligjorë, rregulloreve komunale me të cilat rregullohet puna e inspektorëve sipas fushave përkatëse, duke ju përmbajtur Planit të punës së Drejtoriatit për vitin 2026.

Duke u bazuar nga shkresa zyrtare nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINT) dhe Ligjit për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut me Nr. 08/L-279, pozita e punës për Inspektor komunal të tregut shuhet nga data 06.02.2026, ku funksioni i inspektimit të tregut organizohet dhe ushtrohet vetën në nivel qendror, pra në kuadër të Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut.

Drejtoria për Inspekcione ka hartuar draft rregulloren për Plotësim të Kushteve Minimale Teknike në Komunën e Deçanit, andaj kjo draft rregullore nuk ka kaluar në Asamblenë Komunale për arsye të shuarjes së pozitës së punës të inspektorit të tregut në nivel lokal. Kjo shuarje e pozitës së punës ka ndikuar negativisht në mbikëqyrjen e subjekteve afariste lokale dhe në të hyrat komunale.

Andaj në kuadër të Drejtorisë për Inspekcione, inspektor i rregullt është vetëm Inspektorja për Mbrojtje të Mjedisit; kurse Inspektori i Ndërtimit ka vepruar me kontratë mbi shërbimet e veçanta nga muaj shkurt deri në maj 2026. Gjithashtu edhe Inspektori i Veterinës i angazhuar me kontratë mbi shërbimet e veçanta ka vepruar nga muaji shkurt deri në maj 2026. Nga muaj shkurt 2026, drejtoria për Inspektion nuk ka shefe dhe ushtrues detyre të pozitës së punës.

Inspektorët përkatës sipas fushave inspektuese të tyre kanë vepruar duke kryer inspektime (kontrolle mbikëqyrjeje) në subjektet afariste, inspektori i tregut nga muaji janar deri me datën 06.02.2026, Inspektori i Ndërtimit dhe Veterinarisë nga muaji shkurt deri në muajin maj duke i mbikëqyrë ndërtimet dhe prodhimet bujqësore nga produktet e qumështit. Inspektorja për mbrojtje të mjedisit sipas përgjegjësiave zyrtare ka vepruar në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit (ujin, ajrin, token dhe biodiversitetin) etj.



Drejtoria e Inspekcioneve ka kryer inspektime të përbashkëta me: Stacionin e Policisë, Komisionin për Miniera dhe Minerale, me Inspektoratin e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut ku këto inspektime kanë pasur për qëllim koordinimin e inspektimeve të përbashkëta.

Gjithashtu inspektimet e planifikuara – janë inspektimet të realizuara sipas planit të punës dhe planit të monitorimit; Inspektimi i paplanifikuar ka përfshirë edhe procesin e inspektimeve i cili paraqitet ad-hoc dhe sipas nevojës pozitive zyrtare profesionale të inspektorit; po duke u bazuar edhe në kërkesat e parashtruara sipas kërkesave të personave fizikë dhe juridikë – janë inspektime të realizuara në bazë të paraqitjes së kërkesave në Intranet;

Ri-inspektimi – është inspektimi përcjellës që kryhet gjatë dhe pas kalimit të afatit të caktuar nga inspektori lidhur me përmbushjen e urdhrave apo kërkesave për eliminimin e parregullsive të konstatuara gjatë inspektimit;

Këshilla inspektuese të subjektit të inspektuar për zbatimin sa më korrekt të legjislacionit në fuqi dhe eliminimit të të gjeturave subjekti inspektues si dhe marrjen e masave administrative dhe shqiptimit të gjobave që kanë për qëllim shmangien e rreziqeve që mund t'i shkaktohen shëndetit publik, sigurisë publike, mjedisit dhe interesave të ligjshme të personave fizikë dhe juridikë, të përcaktuara nga ligjet apo me ligje të veçanta.

Janë marrë veprime për shkeljet serioze duke i veçuar ndërtimet në kundërshtim me ligjet në fuqi dhe kushtet urbanistike të lëshuara nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim Hapësinor dhe Mbrotje të Mjedisit, po ashtu edhe njoftime mbi ndërtime pa leje.

Në kuadër të drejtorisë së Inspekcioneve pozitive e punës e Inspektoreve të tregut siç përmendëm më lartë është shuar andaj zyrtarja që ka ushtruar këtë detyrë mos me lënë vakant drejtorinë është angazhuar në detyra administrative si: shqyrtim të kërkesave në intranet, lëshimin e fletëpagesave, taksave administrative-gjobave për fushën e mjedisit përmes sistemit të Intranetit konform Ligjeve, Udhëzimeve Administrative dhe Rregullores Komunale në secilën fushë përkatëse të inspektimit. Duhet të theksohet edhe se janë kryer edhe punë tjera sipas fusheve veprimtarisë të secilit nga inspektorët. Në tabelën në vijim po e prezantojmë aktivitetin e inspektorëve:

**Tabela 1**

| Pozita zyrtare                             | Inspekti<br>me në<br>teren<br>sipas<br>detyrës<br>zyrtare | Inspektime<br>sipas<br>kërkesë-<br>personave<br>fizik dhe<br>juridik | Aktvendime | Gjoba<br>mandatorë | Inspektime<br>për leje të<br>ndërtimit | Inspektime<br>për leje<br>mjedisore | Kërkesa<br>për<br>gjykatë |
|--------------------------------------------|-----------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------|------------|--------------------|----------------------------------------|-------------------------------------|---------------------------|
| Inspektorja<br>për mbrojtje<br>të mjedisit | 21                                                        | 51                                                                   | 15         | 1                  | 6                                      | 6                                   | 0                         |
| Inspektori i<br>tregut                     | 10                                                        |                                                                      |            |                    |                                        |                                     |                           |
| Inspektori i<br>ndërtimit                  | 18                                                        |                                                                      |            |                    |                                        |                                     |                           |
| Inspektori i<br>Veterinarisë               | 8                                                         |                                                                      |            |                    |                                        |                                     |                           |
| Gjithsej                                   | 57                                                        | 51                                                                   | 15         | 1                  | 6                                      | 6                                   | 0                         |

**Kërkesë:** Si çështje e ndjeshme që është ndërtimi dhe cilësia e ushqimit (produkteve të qumështit dhe mishit) zgjidhja dhe çështja e inspektorëve të ndërtimit dhe veterinarisë është e domosdoshme.